



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

**PROCESVERVBAL I PËRMBLEDHUR I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË
LARTË GJYQËSOR**

(Mbajtur, më 05.03.2020)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për ngritjen e grupit të punës për funksionimin e sistemit të menaxhimit të çështjeve pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:12 dhe mbaroi në orën 13:31.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|-----------------------------|--------------------------|
| 1. Naureda Llagami | (kryetare) |
| 2. Maksim Qoku | (zëvendëskryetar) |
| 3. Medi Bici | (anëtar) |
| 4. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 5. Brunilda Kadi | (anëtare) |
| 6. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 7. Ilir Toska | (anëtar) |
| 8. Alban Toro | (anëtar) |
| 9. Brikena Ukperaj | (anëtar) |
| 10. Erjon Muharremaj | (anëtar) |

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 3. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
- 4. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
- 5. Gentiana Bigu, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 6. Alsma Shehu, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 7. Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 8. Gregor Borkowski, EURALIUS.*
- 9. Anisa Kuçi, EURALIUS.*
- 10. Valbona Bala, USAID.*
- 11. Tahir Lamçe, OSCE.*
- 12. Ejona Isufaj, Drejtore e Departamentit të Burimeve Njerëzore.*
- 13. Luljeta Laze, Drejtore e Departamentit të Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.*
- 14. Artur Mamadhaj, Drejtor pranë Departamentit të Auditit.*
- 15. Nertina Kosova, Zëvendëskryetare e Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.*

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Për ngritjen e grupit të punës për funksionimin e sistemit të menaxhimit të çështjeve pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”.

Mbledhja plenare e datës 5 mars 2020 fillon me prezantimin e 10 pikave të rendit të ditës nga ana e Kryetares së Këshillit, zonjës Naureda Llagami.

Pas prezantimit të rendit të ditës, zonja Ukperaj propozon shtimin e një pike në rendin e ditës, pasi nga ana e kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është drejtuar një kërkesë lidhur me mentorimin e kandidatëve për gjyqtarë që zhvillojnë praktikën profesionale në këtë gjykatë dhe praktikisht bëhet fjalë për një nga magjistratët udhëheqës i cili ka ndryshuar seksionin duke kaluar në seksionin penal dhe duhet që Këshilli të marrë masat për zëvendësimin e tij nga një magjistrat tjetër nga dhoma civile. Zonja Ukperaj bën të ditur se anëtarë e Këshillit janë njohur me materialet, në eventualitetin e përfshirjes së kësaj pike në rendin e ditës.

(Anëtarët e Këshillit janë të gjithë dakord për përfshirjen e kësaj pike në rendin e ditës.)

Sa i përket çështjes së parë të rendit të ditës, për të parashtruar problematikat dhe nevojën pse duhet marrë kjo vendimmarrje nga Këshilli, është ftuar zonja Nertina Kosova e cila parashtron shkurtimisht mbi këtë çështje. Zonja Kosova trajton disa nga problematikat të cilat më të detajuara janë trajtuar nga specialisti i IT-së së gjykatës dhe ku janë trajtuar në shkresën e datës 03.03.2020 dhe që mban nr. prot. 1561 të KLGJ-së. Ajo shton se me fillimi i funksionimit të Gjykatave të Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, në datën 19.12.2019, Gjykata e Apelit për Krime të Rënda u emërtua Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe prej kësaj ditë sistemi i menaxhimit të çështjeve nuk është përdorur në pritje të një udhëzimi.

Lidhur me problematikën e shortit elektronik, edhe ky short është jo funksional, pasi të gjitha raportet që gjenerohen dalin ende nën emërtimin e Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda. Sipas ligjit, ndarja e çështjeve me short duhet të bëhet në rrugë elektronike duke u bazuar në transparencë dhe objektivitet.

Zonja Kosova shton se ndarja e çështjeve është bërë me short manual duke u dokumentuar në procesverbal përgatitja e shortit dhe mënyra e njoftimit paraprak të gjyqtarëve nëpërmjet e-mailit zyrtar nga kancelari i gjykatës dhe ky i gjithë ky proces është mbikëqyrur nga kancelari, në prani të zëvendëskryetarit të gjykatës.

Problematika që shfaq mospërdorimi i sistemit ICMIS, - shton në fjalën e saj zonja Kosova, - është transparenca e informacionit mbi planifikimin e çështjeve gjyqësore edhe në pajisjen kioskë që gjendet në hollin e gjykatës si dhe mosgjenerimi i raporteve mbi planifikimin e seancave gjyqësore në sistemin PAKS+.

Rekomandimet që jep zonja Kosova janë: krijimi i një databaze të re duke mos ndryshuar të dhënat ekzistuese që janë gjeneruar deri në momentin e funksionimit të sistemit ICMIS.

Problematikë tjetër të cilën e shpreh zonja Kosova është ai i ndryshimit të emrit në portalin e gjykatave në mënyrë që të vijohet me publikimin e nevojshme sipas legjislacionit.

Në përfundim, zonja Kosova shprehet se për krijimin e databazës së re, hedhjes së shortit elektronik dhe regjistrimin e dosjeve, u është ofruar ndihmë nga EURALIUS.

Pas prezantimit të problematikave nga zonja Kosova, merr fjalën zoti **Erjon Muharremaj** i cili është marrë me problematikat e lartpërmendura nga zonja Kosova. Në fjalën e tij, zoti Muharremaj shprehet se kërkohet një ndërhyrje urgjente në sistemin e menaxhimit të çështjeve duke mos prekur atë çka është regjistruar deri në datën 19.12.2019 nga Gjykata për Krimet e Rënda dhe për të vijuar me veprimtarinë e gjykatës nën emërtimin e ri. Për këtë, zoti Muharremaj falënderon misionin EURALIUS V i cili do të mundësojë funksionalitetin e sistemit të menaxhimit të çështjeve pranë kësaj gjykate dhe më pas i prezanton Këshillit projektvendimin ku i propozohet Këshillit ngritja e një grupi pune me në krye zotin Muharremaj, për marrjen e masave për të bërë funksional sistemin e menaxhimit të çështjeve pranë kësaj gjykate si dhe detyrat që duhet të kryejë ky grup pune i asistuar edhe nga ekspertë të Misionit EURALIUS V. Gjithashtu vlerësohet që afati i realizimit të këtij procesi nga grupi i punës të jetë data 10 prill 2020.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë diskutime, paqartësi apo pyetje rreth këtij projekt-akti, prandaj hidhet në votim nga Kryetarja e Këshillit propozimi i relatuar nga zoti Muharremaj, dhe rezultatet e votimit janë si më poshtë:

Maksim Qoku është dakord.

Brunilda Kadi është dakord.
Dritan Hallunaj është dakord.
Iilir Toska është dakord.
Alban Toro është dakord.
Fatmira Luli është dakord.
Marçela Shehu është dakord.
Erjon Muharremaj është dakord.
Brikena Ukperaj është dakord.
Medi Bici është dakord.
Naureda Llagami është dakord.

Në përfundim Këshilli vendosi: Miratimin e projektvendimit “Për ngritjen e grupit të punës për funksionimin e sistemit të menaxhimit të çështjeve pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”, sipas relatimit të zotit Muharremaj.

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

**PROCESVERVBAL I PËRMBLEDHUR I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË
LARTË GJYQËSOR**

(Mbajtur, më 05.03.2020)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për detajimin dhe shpërndarjen e punonjësve shtesë në disa gjykata”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:12 dhe mbaroi në orën 13:31.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ilir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
10. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 3. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
- 4. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
- 5. Gentiana Bigu, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 6. Alsma Shehu, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 7. Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 8. Gregor Borkowski, EURALIUS.*
- 9. Anisa Kuçi, EURALIUS.*
- 10. Valbona Bala, USAID.*
- 11. Tahir Lamçe, OSCE.*
- 12. Ejona Isufaj, Drejtore e Departamentit të Burimeve Njerëzore.*
- 13. Luljeta Laze, Drejtore e Departamentit të Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.*
- 14. Artur Mamadhaj, Drejtor pranë Departamentit të Auditit.*

RENDI I DITËS:

2. Shqyrtimi i projektvendimit “Për detajimin dhe shpërndarjen e punonjësve shtesë në disa gjykata”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Sa i përket detajimit dhe shpërndarjes së punonjësve shtesë në disa gjykata, zonja Llagami bën një përmbledhje të shkurtër bazuar në nevojat e ardhura nga gjykatat, duke i

dhënë më pas fjalën zonyes Ejona Isufaj, Drejtore e Departamentit të Burimeve Njerëzore pranë KLGJ-së.

Në parashtrimin e saj, zonja Ejona Isufaj shprehet se nga gjykatat janë paraqitur disa kërkesa, në shtrirje kohore të ndryshme, për shpërndarjen e punonjësve dhe pas përlogaritjeve, Departamenti i Burimeve Njerëzore ka propozuar për vitin 2020 detajimin me 11 ndihmës ligjorë në gjykatat administrative; 25 sekretarë regjistruar; 37 nëpunës gjyqësorë; 7 ftues; 1 ekonomist; 1 specialist IT; 5 arkivistë gjyqësorë; 3 magazinierë; 3 sanitarë dhe 6 shoferë/mirëmbajtës me një total prej 99 punonjësish, ku një është kaluar nga KLGJ-ja pranë Gjykatës Administrative të Apelit në janar 2019. Zonja Isufaj i referohet detajeve të cilat gjenden në relacionin bashkëlidhur dosjes së mbledhjes plenare.

Diskutime/Komente/Pyetje/Propozime mbi çështjen

Merr fjalën *zoti Ilir Toska*, i cili pyet nëse janë pasur në konsideratë nevojat e Gjykatës së Lartë në shpërndarjen e punonjësve, duke qenë se me fillimin e funksionimit të Gjykatës së Lartë, ajo do të përballet me një ngarkesë të lartë pune.

Zonja Isufaj, në përgjigje të kësaj pyetjeje shton se është menduar që numri prej 131 punonjësish në Gjykatën e Lartë është i mjaftueshëm.

Atëherë, Zoti Toska propozon që drafti të rishikohet duke shtuar numrin e punonjësve në Gjykatën e Lartë, kjo pasi me stafin që ka, është e pamundur që të evadohen shumë çështje.

Në vijim të kësaj, merr fjalën *zonja Llagami* e cila sqaron se numri 131 punonjës për Gjykatën e Lartë nuk është i plotësuar ende dhe vetëm pas plotësimit të vakancave, atëherë mund të kërkohet një shtesë për punonjës në Gjykatën e Lartë. Më pas zonja Llagami, në përgjigje të pyetjes së zotit Toska sa i përket vakancave, shton faktin se vakancat janë në pozicionin e këshilltarëve ligjorë si dhe në pozicionet në administratë. Gjithashtu shton edhe faktin që Gjykata e Lartë, sipas edhe komunikimeve, duhet të bëjë një ristrukturim të nevojave të saj sa i përket numrit të punonjësve.

Edhe *zoti Muharremaj* merr fjalën për të tërhequr vëmendjen sa i përket plotësimit të paktën në juridiksionin e apelit, me nga 1 nëpunës civil gjyqësorë të

ngarkuar për marrëdhënien me median dhe publikun, ku transparenca është një aspekt shumë i rëndësishëm.

Zonja Isufaj i përgjigjet duke shtuar se koncepti i nëpunësit për marrëdhënien me median dhe publikun ka hyrë me ligjin e ri dhe nuk është pjesë e strukturave ekzistuese të gjykatave dhe vetëm pas ristrukturimit në gjykata, ku të jetë caktuar pozicioni me një kategori page të caktuar, do të jenë këshillat e gjykatave që do të caktojnë koordinatorin për marrëdhëniet me median.

Më pas merr fjalë zonja **Brunilda Kadi** e cila fillimisht bie dakord me atë çka u tha nga Kryetarja e Këshillit që nuk është momenti për të shtuar numrin e punonjësve në Gjykatën e Lartë, pasi fillimisht duhen plotësuar gjyqtarët e më pas stafi dhe, më pas i drejton një pyetje zonjës Isufaj sa i përket nëse bëhet fjalë për ndonjë lapsus në faqen e parë të relacionit ku thuhet “pozicioni “gjyqtarë” – 8”.

Në përgjigje të kësaj, zonja Isufaj sqaron se bëhet fjalë për atë çka kanë kërkuar gjykatat.

Ndërkohë, zonja Kadi sugjeron sa i përket ndihmësve ligjorë, të shtoheshin në Gjykatën e Apelit Vlorë për shkak të ngarkesës që kjo gjykatë ka, duke i hequr nga numri i Gjykatës së Posaçme të Apelit.

Zonja Isufaj sqaron se vetëm Gjykata e Apelit Gjirokastrë ka kërkuar ndihmës ligjorë, ndërsa gjykatat e tjera të apelit nuk kanë kërkuar ndihmës ligjorë. Ndihmësit ligjorë janë parashikuar në detajim si një parashikim i ligjit.

Zonja Brikena Ukperaj bën më pas një sërë pyetjesh, ku e para është nëse detajimi i punonjësve pjesë e administratës gjyqësore është bërë sipas strukturës aktuale apo sipas asaj çfarë parashikon ligji, dhe në përgjigje të kësaj zonja Isufaj shprehet se detajimi është bërë sipas strukturës aktuale.

Pyetja e dytë e zonjës Ukperaj është se çfarë do bëjnë nëpër gjykata nëpunësit gjyqësorë dhe në përgjigje të kësaj zonja Isufaj sqaron se pozicioni i tyre ka lidhje me shërbimet mbështetëse në gjykatë, si bërjen e njoftimeve apo menaxhimin e situatave brenda sallave të gjyqeve.

Pyetja e tretë e zonjës Ukperaj ka lidhje me ndihmësit ligjorë që aktualisht vazhdojnë funksionin në gjykatat e shkallës së parë administrative por që me ligjin e ri

nuk janë pjesë e strukturës, pra a është pasur parasysh ky aspekt në detajimin që është paraqitur në Këshill, dhe në përgjigje të kësaj zonja Isufaj sqaron që numri 11 është lënë enkas për ndihmësit ligjorë duke menduar që edhe numri i studentëve sot në Shkollën e Magjistraturës është 8. Gjithsesi, ajo shprehet se ky numër do të ndryshojë me hartën e re gjyqësore.

Pas pyetjeve nga anëtarët e Këshillit dhe përgjigjeve nga zonja Isufaj, hidhet në votim projektvendimi për shpërndarjen e punonjësve në gjykata, dhe rezultatet e votimit janë si më poshtë:

Maksim Qoku është dakord.

Brunilda Kadi është dakord (duke u tërhequr nga sugjerimi që bëri më lart).

Dritan Hallunaj është dakord.

Illir Toska është dakord.

Alban Toro është dakord.

Fatmira Luli është dakord.

Marçela Shehu është dakord.

Erjon Muharremaj është dakord.

Brikena Ukperaj është dakord.

Medi Bici është dakord.

Naureda Llagami është dakord.

Në përfundim Këshilli vendosi: Miratimin e projektvendimit “Për detajimin dhe shpërndarjen e punonjësve shtesë në disa gjykata” të akorduar nga buxheti i shtetit për vitin 2020, sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi.

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

**PROCESVERVBAL I PËRMBLEDHUR I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË
LARTË GJYQËSOR**

(Mbajtur, më 05.03.2020)

Pika 3 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për rialokimin e fondeve për shërbimin e ruajtjes dhe sigurisë së godinave të gjykatave” i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:12 dhe mbaroi në orën 13:31.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|-----------------------------|--------------------------|
| 1. Naureda Llagami | (kryetare) |
| 2. Maksim Qoku | (zëvendëskryetar) |
| 3. Medi Bici | (anëtar) |
| 4. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 5. Brunilda Kadi | (anëtare) |
| 6. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 7. Ilir Toska | (anëtar) |
| 8. Alban Toro | (anëtar) |
| 9. Brikena Ukperaj | (anëtar) |
| 10. Erjon Muharremaj | (anëtar) |

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 3. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
- 4. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
- 5. Gentiana Bigu, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 6. Alsma Shehu, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 7. Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 8. Gregor Borkowski, EURALIUS.*
- 9. Anisa Kuçi, EURALIUS.*
- 10. Valbona Bala, USAID.*
- 11. Tahir Lamçe, OSCE.*
- 12. Ejona Isufaj, Drejtore e Departamentit të Burimeve Njerëzore.*
- 13. Luljeta Laze, Drejtore e Departamentit të Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.*
- 14. Artur Mamadhaj, Drejtor pranë Departamentit të Auditit.*

RENDI I DITËS:

3. Shqyrtimi i projektvendimit “Për rialokimin e fondeve për shërbimin e ruajtjes dhe sigurisë së godinave të gjykatave” i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Lidhur me detajimin e këtij projekt-akti, relatohet zonja Luljeta Laze, Drejtore e Departamentit të Programimit dhe Administrimit të Buxhetit pranë KLGJ-së.

Në fjalën e saj zonja Laze shprehet se fondi i detajuar me vendimin e Këshillit nr.

323/2019 është 75,800 mijë lekë për shërbimin e ruajtjes së gjykatave të vendit, shërbim ky i cili do të realizohet nga shoqëria Ilyrian Guard sh.a., shoqëri me kapital shtetëror. Gjithashtu zonja Laze shprehet se gjykatat kanë pasur kontrata individuale për ruajtjen e godinave të tyre, me afate kohore të ndryshme për përmbylljen e kontratave, prandaj me mbledhjen e informacionit të duhur nga të gjitha gjykatat, bëhet e mundur tashmë edhe dhënia e fondit gjykatave për të plotësuar përfundimin e kontratave ekzistuese. Gjithçka sa u tha më sipër nga zonja Laze, është e pasqyruar në mënyrë të detajuar në një tabelë bashkëlidhur relacionit shpjegues.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë diskutime, pyetje apo sugjerime për çështjen, prandaj hidhet në votim miratimi i projektvendimit “Për rialokimin e fondeve për shërbimin e ruajtjes dhe sigurisë së godinave të gjykatave”, dhe rezultatet e votimit janë si më poshtë:

Maksim Qoku është dakord.

Brunilda Kadi është dakord.

Dritan Hallunaj është dakord.

Illir Toska është dakord.

Alban Toro është dakord.

Fatmira Luli është dakord.

Marçela Shehu është dakord.

Erjon Muharremaj është dakord.

Brikena Ukperaj është dakord.

Medi Bici është dakord.

Naureda Llagami është dakord.

Në përfundim Këshilli vendosi: 1. Të miratojë rialokimin e fondeve për shërbimin e ruajtjes dhe sigurisë së godinave të gjykatave, sipas pasqyrës bashkëlidhur këtij vendimi. 2. Ngarkohet me zbatimin e këtij vendimi, Departamenti i Programimit dhe Administrimit të Buxhetit. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 3 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

**PROCESVERVBAL I PËRMBLEDHUR I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË
LARTË GJYQËSOR**

(Mbajtur, më 05.03.2020)

Pika 4 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për nxjerrjen nga përdorimi të disa aseteve dhe transferimin kapital të pajisjeve të zyrave”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:12 dhe mbaroi në orën 13:31.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Illir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
10. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 3. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
- 4. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
- 5. Gentiana Bigu, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 6. Alsma Shehu, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 7. Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 8. Gregor Borkowski, EURALIUS.*
- 9. Anisa Kuçi, EURALIUS.*
- 10. Valbona Bala, USAID.*
- 11. Tahir Lamçe, OSCE.*
- 12. Ejona Isufaj, Drejtore e Departamentit të Burimeve Njerëzore.*
- 13. Luljeta Laze, Drejtore e Departamentit të Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.*
- 14. Artur Mamadhaj, Drejtor pranë Departamentit të Auditit.*

RENDI I DITËS:

4. Shqyrtimi i projektvendimit “Për nxjerrjen nga përdorimi të disa aseteve dhe transferimin kapital të pajisjeve të zyrave” i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Sërish për relatimin e projektvendimit “Për nxjerrjen nga përdorimi të disa aseteve dhe transferimin kapital të pajisjeve të zyrave” ftohet zonja Luljeta Laze.

Zonja Laze bën një përmbledhje të shkurtër mbi nevojat që Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka për nxjerrjen jashtë nga përdorimi të një automjeti Alfa Romeo dhe gjashtë motoçikletave. Kjo procedurë kontrollohet nga specialistë të Drejtorisë së Investimeve të cilët pasi vlerësojnë që procedura është e rregullt atëherë kalohet për miratim në Këshill. Më pas zonja Laze shton se është parë e nevojshme që të nxirren jashtë përdorimit edhe një motoçikletë si dhe një automjet Volkswagen Bora në KLGJ.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë diskutime, pyetje apo sugjerime për çështjen, prandaj hidhet në votim miratimi i projektvendimit “Për nxjerrjen nga përdorimi të disa aseteve dhe transferimin kapital të pajisjeve të zyrave”, dhe rezultatet e votimit janë si më poshtë:

Maksim Qoku është dakord.

Brunilda Kadi është dakord.

Dritan Hallunaj është dakord.

Iilir Toska është dakord.

Alban Toro është dakord.

Fatmira Luli është dakord.

Marçela Shehu është dakord.

Erjon Muharremaj është dakord.

Brikena Ukperaj është dakord.

Medi Bici është dakord.

Naureda Llagami është dakord.

Në përfundim Këshilli vendosi: 1. Miratimin për nxjerrjen nga përdorimi të aseteve si më poshtë: - automjetin tip “Alfa Romeo 156” me targa TR 0221 Z, prodhim i vitit 2002 në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë; - të 6 copë motoçikletave të tipit “Loncin” me targa TR 941C; TR 942C; TR 943C; TR 944C; TR 945C dhe TR 946C, prodhim i vitit 2004, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë; - automjetin tip “Volkswagen Bora” me targa AA528 JU, prodhim i vitit 2000, në Këshillin e Lartë Gjyqësor; - motoçikletën tip “Peugeot”, me volum motori 49 cc, në Këshillin e Lartë

Gjyqësor. 2. Miratimin e transferimit kapital të pajisjeve të zyrave të ish-Zyrës së Administrimit Gjyqësor në favor të Gjykatave të Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, sipas pasqyrës 1, bashkëlidhur këtij vendimi. 3. Ngarkohet me zbatimin e këtij vendimi, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe struktura përkatëse pranë Këshillit. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Pas miratimit të këtij projektvendimi, merr fjalën zonja Ukperaj e cila propozon që për sa kohë nxjerrja e aseteve jashtë përdorimit janë pjesë e buxhetit dhe kalojnë thjesht nga një gjykatë në tjetrën, nuk do ishte e nevojshme që të kalohet në mbledhje plenare dhe mund të kihet parasysh kur të bëhet rregullorja që për çështje që nuk kanë lidhje me administrimin në tërësi të buxhetit, të mos impenjohet mbledhja plenare.

Në përgjigje të kësaj, për ta përmbyllur edhe këtë pikë, zonja Llagami shton që me bërjen e rregullores së brendshme, disa çështje mund t'i lihen kompetencë Komisionit që mos të ngarkohet Këshilli.

* * *

(Pika 4 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

**PROCESVERVBAL I PËRMBLEDHUR I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË
LARTË GJYQËSOR**

(Mbajtur, më 05.03.2020)

Pika 5 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e “Rregullore për parandalimin e konfliktit të interesave dhe deklarimin e pasurive në ushtrimin e funksioneve publike në Këshillin e Lartë Gjyqësor””, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:12 dhe mbaroi në orën 13:31.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Illir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)

10. Erjon Muharremaj (anëtar)

11. Marçela Shehu (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 3. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
- 4. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
- 5. Gentiana Bigu, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 6. Alsma Shehu, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 7. Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 8. Gregor Borkowski, EURALIUS.*
- 9. Anisa Kuqi, EURALIUS.*
- 10. Valbona Bala, USAID.*
- 11. Tahir Lamçe, OSCE.*
- 12. Ejona Isufaj, Drejtore e Departamentit të Burimeve Njerëzore.*
- 13. Luljeta Laze, Drejtore e Departamentit të Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.*
- 14. Artur Mamadhaj, Drejtor pranë Departamentit të Auditit.*

RENDI I DITËS:

5. Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e “Rregullore për parandalimin e konfliktit të interesave dhe deklarimin e pasurive në ushtrimin e funksioneve publike në Këshillin e Lartë Gjyqësor””, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Lidhur me miratimin e Rregullores për parandalimin e konfliktit të interesave dhe

deklarimin e pasurive në ushtrimin e funksioneve publike në Këshillin e Lartë Gjyqësor, relatimi bëhet nga Drejtoresha e Departamentit të Burimeve Njerëzore, zonja Isufaj.

Zonja Isufaj sqaron se Rregullorja për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike në KLGJ duhet të jetë pjesë e akteve rregullatore të saj. Hartimi i kësaj rregulloreje është kërkuar në mënyrë shkresore nga ILDKPKI dhe si rrjedhojë, pranë KLGJ-së është ngritur një grup pune i cili ka përgatitur rregulloren ku janë parashikuar rregullat kryesore dhe përkufizimet për sa i përket konfliktit të interesit, si dhe në anekset bashkëlidhur, janë parashikuar i gjithë dokumentacioni që duhet të përgatitet nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe autoriteti që do të ngarkohet për konfliktin e interesit, dokumentacione të cilat janë standarde edhe në një pjesë të mirë të institucioneve.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë diskutime, pyetje apo sugjerime për çështjen, prandaj hidhet në votim miratimi i projektvendimit “Për miratimin e “Rregullore për parandalimin e konfliktit të interesave dhe deklarimin e pasurive në ushtrimin e funksioneve publike në Këshillin e Lartë Gjyqësor””, dhe rezultatet e votimit janë si më poshtë:

Maksim Qoku është dakord.

Brunilda Kadi është dakord.

Dritan Hallunaj është dakord.

Illir Toska është dakord.

Alban Toro është dakord.

Fatmira Luli është dakord.

Marçela Shehu është dakord.

Erjon Muharremaj është dakord.

Brikena Ukperaj është dakord.

Medi Bici është dakord.

Naureda Llagami është dakord.

Në përfundim Këshilli vendosi: Të miratojë “Rregullore për parandalimin e

konfliktit të interesave dhe deklarimin e pasurive në ushtrimin e funksioneve publike në Këshillin e Lartë Gjyqësor”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 5 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

**PROCESVERVBAL I PËRMBLEDHUR I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË
LARTË GJYQËSOR**

(Mbajtur, më 05.03.2020)

Pika 6 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e “Raport Vjetor i Auditimit të Pushtetit Gjyqësor për vitin 2019”” i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:12 dhe mbaroi në orën 13:31.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|-----------------------------|--------------------------|
| 1. Naureda Llagami | (kryetare) |
| 2. Maksim Qoku | (zëvendëskryetar) |
| 3. Medi Bici | (anëtar) |
| 4. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 5. Brunilda Kadi | (anëtare) |
| 6. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 7. Ilir Toska | (anëtar) |
| 8. Alban Toro | (anëtar) |
| 9. Brikena Ukperaj | (anëtar) |
| 10. Erjon Muharremaj | (anëtar) |

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 3. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
- 4. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
- 5. Gentiana Bigu, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 6. Alsma Shehu, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 7. Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 8. Gregor Borkowski, EURALIUS.*
- 9. Anisa Kuçi, EURALIUS.*
- 10. Valbona Bala, USAID.*
- 11. Tahir Lamçe, OSCE.*
- 12. Luljeta Laze, Drejtore e Departamentit të Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.*
- 13. Artur Mamadhaj, Drejtor pranë Departamentit të Auditit.*

RENDI I DITËS:

6. Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e “Raport Vjetor i Auditimit të Pushtetit Gjyqësor për vitin 2019”” i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Lidhur me miratimin e Raportit Vjetor të auditimit të pushtetit gjyqësor për vitin 2019, relatimi bëhet nga zoti Artur Mamadhaj, Drejtor pranë Departamentit të Auditit.

Zoti Mamadhaj shprehet se dy kanë qenë kolonat që aktivitet i auditimit për vitin 2019 është mbështetur në: i) Planin strategjik për vitin 2019 dhe ii) Paketën ligjore që

lidhet me auditimin.

Më pas zoti Mamadhaj shton se 13 kanë qenë misionet audituese në planin vjetor të auditimit, duke u realizuar 12 prej tyre dhe duke mbetur pa u realizuar një mision auditues në Gjykatën Administrative Gjirokastër për shkak se e gjithë trupa audituese ka qenë e fokusuar në auditimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, si gjykata më e madhe në vend.

Më pas zoti Mamadhaj rendit një sërë objektivash që kjo drejtori ka pasur për vitin 2019, ndër to përmend:

Auditimi i buxheteve faktike për vitet 2018-2019;

Realizimi i dispozitave ligjore në kryerjen e veprimtarisë financiare në fushën e shpenzimeve që kryejnë gjykatat;

Zbatimi i ligjit në fushën e prokurimeve;

Rregullshmëri në mbajtjen dokumentacionit financiar; Krijimi dhe funksionimi i kontrollit të brendshëm dhe llogaridhënies në gjykata;

Rregullshmëri të kryerjes së marrëdhënieve financiare;

Zbatimi i ligjit në përlllogaritjet vjetore që paraqiten në Ministrinë e Financave;

Vlerësimi i rrishtit dhe krijimi i një regjistri kombëtar të rrishtit në gjyqësor;

Inventarizimi dhe ruajtja e administrimit të pasurisë publike;

Zbatimi i standardeve në administrimin dhe menaxhimin e kontrollit publik;

Vlerësimi i shërbimeve gjyqësore në përputhje me popullsinë dhe gjykatën e audituar.

Sa i përket rekomandimeve të auditimit për vitin 2019, zoti Mamadhaj liston një sërë gjykatash bashkë me numrin e rekomandimeve për secilën, të dhëna këto të nxjerra në tabelën përkatëse dhe ajo çka është e rëndësishme për t'u theksuar, -shton zoti Mamadhaj, -është fakti se ka nivel të ulët sa i përket dëmit financiar i cili rezulton në masën 136 mijë lekë dhe është më i ulëti në historinë e auditimit gjyqësor. Sa i përket këtij dëmi ekonomik, rezulton që është kryesisht në pjesën e pagesave për shkak të moskuptimit të ligjit nga nëpunësi zbatues dhe nga kancelarët e gjykatave.

Gjithashtu, zoti Mamadhaj shprehet se me shkresën nr. 4823 prot., datë 01.10.2019, Drejtorja e Auditimit të Brendshëm, nëpërmjet Kryetares së KLGJ-së, u ka

kërkuar informacion 13 gjykatave të audituara në lidhje me progresin që është bërë në zbatim të rekomandimeve të lëna në auditimin e kryer gjatë vitit 2018. Gjykatat janë përgjigjur në kohë dhe për këtë qëllim është nxjerrë edhe pasqyra përkatëse nga e cila rezulton se nga 180 rekomandime të dhëna për zbatim, 136 janë zbatuar dhe 54 janë në proces.

Në përfundim, sa i përket konkluzioneve, zoti Mamadhaj shprehet se pushteti gjyqësor paraqet një performancë të mirë në menaxhimin e fondeve buxhetore, performancë të mirë në menaxhimin e burimeve njerëzore, performancë shumë të mirë në shërbimet gjyqësore për sa i përket vitit 2019.

Mbi bazën e auditimeve faktike të kryera, në përfundim të raportimit, kjo strukturë ka paraqitur disa rekomandime të qenësishme, që në opinionin e auditimit vlerësohen si vlerë e shtuar për gjyqësorin në vitin 2020. Këto rekomandime konsistojnë:

- Nevojë imediate e bërjes së një rregulloreje të unifikuar sipas juridiksioneve;
- Identifikimi i çdo pozicioni pune duke qartësuar përgjegjësitë që do të ketë çdo pozicion;
- Miratimi i organigramave për çdo gjykatë;
- Standarde në emërim të punonjësve;
- Unifikimi i dosjeve të personelit të punonjësve;
- Pagesa për tarifat e psikologëve (asistues dhe ekspertë/vlerësues);
- Politika e prokurimeve duke krijuar unifikim në gjyqësor dhe kjo të bëhet nëpërmjet Këshillit të Lartë Gjyqësor, nëpërmjet departamentit përkatës;
- Shpenzimet postare në gjykata, ku Posta Shqiptare merr 17% të shpenzimeve.

Diskutime/Komente/Pyetje/Propozime mbi çështjen

Merr fjalën *zonja Brunilda Kadi* e cila pyet nëse ka ndonjë sugjerim nga ana e auditit se çfarë duhet të bëjë Këshilli për të përmirësuar situatën, për shembull për shpenzimet postare si dhe pyet se çfarë është sugjeruar nga auditimi për pagesat jashtë orarit? –pasi në gjykata të ndryshme, ka praktika të ndryshme për pagesat jashtë orarit. – A është e unifikuar kjo si praktikë? Gjithashtu zonja Kadi rekomandon që në fund të raportit, auditimi të listonte problemet që ka identifikuar

Në përgjigje, zoti Mamadhaj shprehet se auditi jep gjetje, rekomandime dhe nuk bën kurrë konstatime dhe jep një shembull nga raporti sa i përket shërbimit postar, ku në raport është konstatuar se fatura e operatorit “Posta Shqiptare” shoqërohet në disa raste me kopje të regjistrit postar mujor të operatorit, por nuk ka një dokumentacion tjetër në gjykatë që të verifikojë se sa nga këto njoftime janë kryer nga nëpunësi/ftuesi i gjykatës dhe sa nga këto janë dërguar nëpërmjet zyrës postare. Nga ekzaminimi i regjistrit postar rezulton se vlerën më të lartë në totalin e faturave e zënë flet thirrjet për njoftime të palëve për datat e zhvillimit të seancave gjyqësore dhe njoftimeve të akteve, ndërkohë që ky shërbim duhet të parapaguhet nga palët ose të përdoren mënyrat e tjera të njoftimit në zbatim të KPC nenet, 128-144 dhe 154-158. Nga dokumentacioni i audituar rezulton se nuk ka një dokument të shkruar dhe të miratuar për procedurat që duhet të ndiqen për njoftimet, personat përgjegjës si dhe arkëtimet për këto shpenzime në zbatim të nenit 156 pika b), paragrafi dytë të KPC “Me paraqitjen e kërkesëpadisë paguhet tarifa, si dhe shpenzimet e nevojshme për njoftimet ose shërbimet e tjera gjyqësore”. Sugjerimet që jep auditi është që Këshilli duhet të hartojë një praktikë të shkruar unifikuese se si duhet të operohet me këtë praktikë. Qëllimi do të ishte që nga 18% të shkojë 10%.

Zonja Kadi pyet nëse është gjetur ndonjë shkelje në zbatimin e kësaj procedure për shembull nëse përputhet fatura e postës me njoftimet reale?

Zoti Mamadhaj bën një shembull ku qytetari shkon në gjykatë për të depozituar padinë dhe duke paguar njoftimet për shërbimet.

Më pas merr fjalën **zonja Marçela Shehu** e cila shprehet se evidentimi i auditit është se gjykatat nuk janë të suksesshme në vjeljen e shpenzimeve gjyqësore?

Sërish **zoti Mamadhaj** i përgjigjet se nga posta ka edhe fatura përmbledhëse, por auditi nuk ka kontroll të faturave që posta sjell në gjykatë. Sugjerimi i tij është që gjykata të ketë një person përgjegjës që të firmosë dhe të bëjë ndarjen e njoftimeve edhe nëpërmjet peshës.

Ndër të tjera, **zonja Kadi** sugjeron gjithashtu që çfarë duhet të përmirësojë Këshilli dhe çfarë duhet të kërkohet nga Posta Shqiptare, pra të gjendet një mekanizimës se si mund të kontrollojmë postën, apo një tjetër sugjerim do të ishte që Këshilli të udhëzonte gjykatat që të lidhnin kontratë me një tjetër shërbim më me kosto të ulët.

Zoti Mamadhaj merr sërish fjalën duke thënë se rekomandimi për zgjidhjen është në raport dhe flitet për një mekanizëm kontrolli që i mungon gjykatës/Këshillit.

Sa i përket mekanizmit të kontrollit, **zonja Shehu** pyet nëse ka ndonjë ide apo sugjerim konkret mbi mekanizmin e kontrollit që sugjeron auditi? –dhe zoti Mamadhaj i përgjigjet që nga auditi kërkohet një dokument i shkruar ku të miratohen të gjitha procedurat që duhet të ndiqen me njoftimet në gjykata, personat përgjegjës si dhe arkëtimet për këto shpenzime.

Ndërsa, sa i përket pagesave të orëve jashtë orarit, zoti Mamadhaj sqaron se më parë me vendim të Bordit të ZABGJ-së ka pasur një praktikë të unifikuar dhe në fund të vitit 2019 ka dalë një VKM që e ndalon këtë. Ai sqaron se në auditimin që është bërë në 13 gjykata, praktika ka qenë e njëjtë.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë më diskutime, pyetje apo sugjerime për çështjen, prandaj hidhet në votim miratimi i Raportit, dhe rezultatet e votimit janë si më poshtë:

Maksim Qoku është dakord.

Brunilda Kadi është dakord.

Dritan Hallunaj është dakord.

Illir Toska është dakord.

Alban Toro është dakord.

Fatmira Luli është dakord.

Marçela Shehu është dakord.

Erjon Muharremaj është dakord.

Brikena Ukperaj është dakord.

Medi Bici është dakord.

Naureda Llagami është dakord.

Në përfundim Këshilli vendosi: Të miratojë “Raportin vjetor të auditimit të pushtetit gjyqësor për vitin 2019”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 6 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

**PROCESVERVBAL I PËRMBLEDHUR I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË
LARTË GJYQËSOR**

(Mbajtur, më 05.03.2020)

Pika 7 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e formularit të integruar të vlerësimit të gjyqtarit”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:12 dhe mbaroi në orën 13:31.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|-----------------------------|--------------------------|
| 1. Naureda Llagami | (kryetare) |
| 2. Maksim Qoku | (zëvendëskryetar) |
| 3. Medi Bici | (anëtar) |
| 4. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 5. Brunilda Kadi | (anëtare) |
| 6. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 7. Ilir Toska | (anëtar) |
| 8. Alban Toro | (anëtar) |
| 9. Brikena Ukperaj | (anëtar) |
| 10. Erjon Muharremaj | (anëtar) |

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 3. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
- 4. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
- 5. Gentiana Bigu, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 6. Alsma Shehu, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 7. Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 8. Gregor Borkowski, EURALIUS.*
- 9. Anisa Kuçi, EURALIUS.*
- 10. Valbona Bala, USAID.*
- 11. Tahir Lamçe, OSCE.*
- 12. Luljeta Laze, Drejtore e Departamentit të Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.*

RENDI I DITËS:

7. Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e formularit të integruar të vlerësimit të gjyqtarit”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale.

Relatore e kësaj çështjeje është zonja Brikena Ukperaj.

Në fjalën e saj zonja Ukperaj bën një përmbledhje të relacionit shpjegues lidhur me përmbajtjen e projektvendimit “Për miratimin e formularit të integruar të vlerësimit të gjyqtarit”. Fillimisht ajo shprehet mbi qëllimin e këtij akti i cili ka qenë i nevojshëm për t’u hartuar pasi ka qenë detyrim i ligjit që, Këshilli duhet të miratojë formate të

standardizuara të mënyrës sesi gjyqtarët bëjnë vetëvlerësimin dhe sesi kryetarët japin mendimet paraprake dhe përfundimtare. Gjithashtu formulari lehtëson edhe punën e atyre që janë të detyruar ta plotësojnë, pasi të dyja këto mënyra vlerësimi janë integruar në mënyrë të strukturuar në një dokument të vetëm. Zonja Ukperaj shton se drafti final i hartuar është konsultuar edhe me kryetarët e gjykatave, mendimet e të cilëve janë përfshirë në hartimin e këtij formulari, formular i cili është konceptuar në tre pjesë (këtu zonja Ukperaj lexon pjesë nga relacioni i cili gjendet bashkëlidhur dosjes së mbledhjes plenare): i) Hapat e plotësimit të formularit, vetëvlerësimi i gjyqtarit, vlerësimi i kryetarit dhe standardet e mendimit të kryetarit – në këtë pjesë të formularit janë formuluar rregullat e përgjithshme për plotësimin e formularit, ndërsa sa i përket vlerësimin të kryetarit, ai fillimisht të fillojë me mendimin paraprak të tij, të vazhdojë me kundërshtimet e gjyqtarit dhe të përfundojë me mendimin përfundimtar të kryetarit; ii) Vlerësimi përkundrejt kritereve vlerësuese – ku katër grup kriteret mbi të cilat bëhet vlerësimi etik dhe profesional i gjyqtarit janë “Aftësitë profesionale”, “Aftësitë organizative”, “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale” dhe “Aftësitë personale dhe angazhimi profesional”; iii) Të dhëna të tjera – në këtë pjesë të formularit janë përcaktuar disa çështje për të cilat gjyqtari jep mendimin e tij lidhur me masat e ndërmarra për përmbushjen e objektivave të përcaktuara në vlerësimin e mëparshëm dhe shkallën e përmbushjes së tyre, objektivat për zhvillimin e tij profesional për vlerësimin e ardhshëm dhe identifikimin e nevojave për trajnim.

Ndër të tjera në relacion i propozohet mbledhjes plenare:

- Miratimi i “Formularit të integruar të vlerësimin të gjyqtarit”, sipas formatit bashkëlidhur, pjesë përbërëse e projektvendimit. Ky formular hartohet në formatin shkresor dhe/ose elektronik.

Anëtarët e Këshillit për këtë çështje të rendit të ditës nuk kanë diskutime, pyetje apo sugjerime, prandaj hidhet në votim nga Kryetarja e Këshillit propozimi i Komisionit të Vlerësimin të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale mbi projektvendimin “Për miratimin e formularit të integruar të vlerësimin të gjyqtarit”, dhe rezultatet e votimit janë si më poshtë:

Maksim Qoku është dakord.
Brunilda Kadi është dakord.
Dritan Hallunaj është dakord.
Iilir Toska është dakord.
Alban Toro është dakord.
Fatmira Luli është dakord.
Marçela Shehu është dakord.
Erjon Muharremaj është dakord.
Brikena Ukperaj është dakord.
Medi Bici është dakord.
Naureda Llagami është dakord.

Në përfundim Këshilli vendosi: Miratimin e “Formularit të integruar të vlerësimit të gjyqtarit”, sipas formatit bashkëlidhur, pjesë përbërëse e këtij vendimi. “Formulari i integruar i vlerësimit të gjyqtarit” hartohet në format shkresor dhe/ose elektronik, të cilët kanë vlerë të njëjtë. Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Pas shqyrtimit të kësaj pike, anëtarët e Këshillit bëjnë 8 minuta pushim për të rifilluar më pas me pikat e tjera të rendit të ditës.

* * *

(Pika 7 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

**PROCESVERVBAL I PËRMBLEDHUR I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË
LARTË GJYQËSOR**

(Mbajtur, më 05.03.2020)

Pika 8 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e përhershëm në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar të gjyqtarës {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:12 dhe mbaroi në orën 13:31.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|-----------------------------|--------------------------|
| 1. Naureda Llagami | (kryetare) |
| 2. Maksim Qoku | (zëvendëskryetar) |
| 3. Medi Bici | (anëtar) |
| 4. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 5. Brunilda Kadi | (anëtare) |
| 6. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 7. Ilir Toska | (anëtar) |
| 8. Alban Toro | (anëtar) |
| 9. Brikena Ukperaj | (anëtar) |
| 10. Erjon Muharremaj | (anëtar) |

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 3. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
- 4. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
- 5. Gentiana Bigu, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 6. Alsma Shehu, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 7. Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 8. Gregor Borkowski, EURALIUS.*
- 9. Anisa Kuçi, EURALIUS.*
- 10. Valbona Bala, USAID.*
- 11. Tahir Lamçe, OSCE.*
- 12. Luljeta Laze, Drejtore e Departamentit të Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.*

RENDI I DITËS:

8. Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e përhershëm në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar të gjyqtarës {...}” i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Rifillon mbledhja e Këshillit pas 8 minutave të pushimit nga ana e anëtarëve.

Relator i kësaj çështjeje është zoti Ilir Toska.

Merr fjalën zoti Ilir Toska i cili relaton relacionin shpjegues lidhur me përmbajtjen e projektvendimit “Për caktimin e përhershëm në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar të gjyqtarës {...}”.

Zoti Toska shprehet se sipas vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 286, datë 18.12.2019 Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda është emëruar Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe po atë ditë, duke qenë përpara detyrimit ligjor, caktoi në mënyrë të përkohshme në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, gjyqtaren znj. {...} dhe ende nuk kishte një vendim të formës së prerë për konfirmimin e saj në detyrë. Ndërkohë me vendimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 215, datë 04.12.2019, vendim ky që ka marrë formë të prerë pa u ankimuar, gjyqtarja ka kaluar me sukses procesin e rivlerësimit, për rrjedhojë Këshilli i Lartë Gjyqësor ka detyrimin që në zbatim të nenit 162/2 të ligjit për Statusin të bëjë caktimin në pozicion në mënyrë të përhershme në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar të gjyqtares {...}.

Anëtarët e Këshillit për këtë çështje të rendit të ditës nuk kanë diskutime, pyetje apo sugjerime, prandaj hidhet në votim nga Kryetarja e Këshillit propozimi i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës mbi projektvendimin “Për caktimin e përhershëm në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar të gjyqtares {...}”, dhe rezultatet e votimit janë si më poshtë:

Maksim Qoku është dakord.

Brunilda Kadi është dakord.

Dritan Hallunaj është dakord.

Illir Toska është dakord.

Alban Toro është dakord.

Fatmira Luli është dakord.

Marçela Shehu është dakord.

Erjon Muharremaj është dakord.

Brikena Ukperaj është dakord.

Medi Bici është dakord.

Naureda Llagami është dakord.

Në përfundim Këshilli vendosi: 1. Caktimin në pozicion, në mënyrë të përhershme, të gjyqtares znj.{...} pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. 2. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtares znj.{...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. 3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

* * *

(Pika 8 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

**PROCESVERVBAL I PËRMBLEDHUR I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË
LARTË GJYQËSOR**

(Mbajtur, më 05.03.2020)

Pika 9 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të rekrutimit si gjyqtar të kandidatëve për magjistratë, profili gjyqtar, që pritet të diplomohen në vitin akademik 2019-2020”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:12 dhe mbaroi në orën 13:31.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Illir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)

- 10. Erjon Muharremaj* (anëtar)
11. Marçela Shehu (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 3. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
- 4. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
- 5. Gentiana Bigu, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 6. Alsma Shehu, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 7. Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 8. Gregor Borkowski, EURALIUS.*
- 9. Anisa Kuqi, EURALIUS.*
- 10. Valbona Bala, USAID.*
- 11. Tahir Lamçe, OSCE.*
- 12. Luljeta Laze, Drejtore e Departamentit të Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.*

RENDI I DITËS:

9. Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të rekrutimit si gjyqtar të kandidatëve për magjistratë, profili gjyqtar, që pritet të diplomohen në vitin akademik 2019-2020”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Relator i kësaj çështjeje është zoti Ilir Toska.

Merr fjalën zoti Ilir Toska i cili relaton relacionin shpjegues lidhur me përmbajtjen e projektvendimit “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe

kritereve ligjore të rekrutimit si gjyqtar të kandidatëve për magistratë, profili gjyqtar, që pritet të diplomohen në vitin akademik 2019-2020”.

Ndër të tjera, zoti Toska shprehet se referuar kuadrit ligjor në fuqi, procesi i verifikimit të pasurisë dhe figurës për gjyqtarët e rekrutuar rishtazi, fillon brenda një jave nga publikimi dhe dërgimi pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, prej Shkollës së Magjistraturës, të listës së kandidatëve magistratë, të diplomuar në formimin fillestar gjatë vitit respektiv akademik si dhe Këshilli duhet të shprehet për emërimin apo refuzimin e emërimit të të diplomuarve brenda një muaji nga data e publikimit të listës së të diplomuarve (neni 35/4 e ligjit për Statusin) dhe më pas Këshilli brenda muajit korrik duhet të caktojë në pozicion të emëruarit e sapodiplomuar (neni 39/2 e ligjit për Statusin).

Ndërkohë, për realizimin e procesit të verifikimit të pasurisë dhe figurës, Këshilli i Lartë Gjyqësor duhet të administrojë informacione/raporte nga të gjithë subjektet që ligji përcakton dhe duke qenë se për këto subjekte ligji nuk ka përcaktuar afat kohor, përmbyllja në kohë e procesit të verifikimit të pasurisë dhe figurës për kandidatët për gjyqtarë, kushtëzohet nga raportimet në kohë të subjekteve që ligji përcakton. Ky proces do të ishte objektivisht i pamundur për t’u përmbyllur brenda muajit korrik, prandaj për ta përmbyllur atë brenda muajit korrik Këshilli i Lartë Gjyqësor do të duhet të konsiderojë fillimin më herët të procesit të verifikimit të pasurisë dhe figurës për ata.

Më tej zoti Toska shprehet se Shkolla e Magjistraturës, mbështetur edhe nga rrethanat objektive për përfundimin në kohë të procesit të verifikimit të pasurisë dhe figurës për këta kandidatë, ka dërguar një listë me emrat e trembëdhjetë kandidatëve për magistratë, që janë në pritje për t’u diplomuar, në vitin akademik 2019-2020, në përfundim të vitit të tretë të Programit Trevjeçar të Formimit Fillestar si dhe një listë me emrat e gjashtë kandidatëve për magistratë, që janë në pritje për t’u diplomuar, në vitin akademik 2019-2020, në përfundim të vitit të dytë të Programit Dyvjeçar të Trajnimit, ndaj referuar kuadrit ligjor në fuqi.

Për sa më lart, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor:

- Fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të rekrutimit si gjyqtar të kandidatëve për magistratë, profili gjyqtar, që pritet të diplomohen

në vitin akademik 2019-2020 si dhe caktimin e relatorit për secilin kandidat.

Anëtarët e Këshillit për këtë çështje të rendit të ditës nuk kanë diskutime, pyetje apo sugjerime, prandaj hidhet në votim nga Kryetarja e Këshillit propozimi i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të rekrutimit si gjyqtar të kandidatëve për magjistratë, profili gjyqtar, që pritet të diplomohen në vitin akademik 2019-2020, dhe rezultatet e votimit janë si më poshtë:

Maksim Qoku është dakord.

Brunilda Kadi është dakord.

Dritan Hallunaj është dakord.

Illir Toska është dakord.

Alban Toro është dakord.

Fatmira Luli është dakord.

Marçela Shehu është dakord.

Erjon Muharremaj është dakord.

Brikena Ukperaj është dakord.

Medi Bici është dakord.

Naureda Llagami është dakord.

Më pas zhvillohet procedura e caktimit të relatorëve për secilin kandidat duke u futur në një vazo të tejdukshme shiritat e letrës me emrat e 3 anëtarëve të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, në një vazo tjetër shiritat e letrës me emrat e 13 kandidatëve për magjistratë, që janë në pritje për t'u diplomuar, në vitin akademik 2019-2020, në përfundim të vitit të tretë të Programit Trevjeçar të Formimit Fillestar dhe në një vazo tjetër shiritat e letrës me emrat e 6 kandidatëve për magjistratë, që janë në pritje për t'u diplomuar, në vitin akademik 2019-2020, në përfundim të vitit të dytë të Programit Dvjeçar të Trajnimit. Gjithashtu, sipas propozimit të Komisionit, shpërndarja e punës nëpërmjet anëtarëve të Komisionit të jetë e tillë: 3 kandidatë kryetari i Komisionit (1 kandidat nga grupi i parë i magjistratëve dhe 2 kandidatë nga grupi i dytë i magjistratëve), 8 kandidatë znj. Shehu (6 kandidatë nga grupi i parë i magjistratëve dhe 2

kandidatë nga grupi i dytë i magjistratëve) dhe 8 kandidatë z.Toro (6 kandidatë nga grupi i parë i magjistratëve dhe 2 kandidatë nga grupi i dytë i magjistratëve).

Procedura e hedhjes së shortit do të jetë e tillë ku fillimisht do të tërhiqet emri i anëtarit dhe më pas emrat e kandidatëve përkatës për atë relator. Pas procedurës së shortit, rezultatet janë si më poshtë:

Anëtari zoti Alban Toro do të jetë relator për: znj. {...}, z. {...}, znj. {...}, z. {...}, znj. {...}, znj. {...}, znj. {...} dhe z. {...}.

Anëtarja zonja Marçela Shehu do të jetë relatores për: znj. {...}, z. {...}, znj. {...}, znj. {...}, z. {...}, znj. {...}, z. {...} dhe znj. {...}.

Anëtari zoti Ilir Toska do të jetë relator për: znj. {...}, z. {...} dhe znj. {...}.

Pas caktimit të relatorit për secilin kandidat, hidhet në votim akti në tërësi, dhe rezultatet e votimit janë si më poshtë:

Maksim Qoku është dakord.

Brunilda Kadi është dakord.

Dritan Hallunaj është dakord.

Ilir Toska është dakord.

Alban Toro është dakord.

Fatmira Luli është dakord.

Marçela Shehu është dakord.

Erjon Muharremaj është dakord.

Brikena Ukperaj është dakord.

Medi Bici është dakord.

Naureda Llagami është dakord.

Në përfundim, Këshilli vendosi: Fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të rekrutimit si gjyqtar të kandidatëve për magjistratë, profili gjyqtar, që pritet të diplomohen në vitin akademik 2019-2020.

Caktimin e relatorit për secilin kandidat, si më poshtë:

1. Për kandidatin z. {...} - relator z. Alban Toro;

2. Për kandidaten znj. {...} - relator z. Alban Toro;
3. Për kandidaten znj. {...} - relator z. Ilir Toska;
4. Për kandidaten znj. {...} - relator znj. Marçela Shehu;
5. Për kandidatin z. {...} - relator znj. Marçela Shehu;
6. Për kandidaten znj. {...} - relator znj. Marçela Shehu;
7. Për kandidatin z. {...} - relator znj. Marçela Shehu;
8. Për kandidatin z. {...} - relator z. Alban Toro;
9. Për kandidaten znj. {...} - relator z. Alban Toro;
10. Për kandidaten znj. {...} - relator znj. Marçela Shehu;
11. Për kandidaten znj. {...} - relator z. Alban Toro;
12. Për kandidaten znj. {...} - relator znj. Marçela Shehu;
13. Për kandidaten znj. {...} - relator z. Alban Toro;

-
14. Për kandidatin z. {...} - relator z. Alban Toro;
 15. Për kandidaten znj. {...} - relator znj. Marçela Shehu;
 16. Për kandidatin z. {...} - relator znj. Marçela Shehu;
 17. Për kandidatin z. {...} - relator z. Ilir Toska;
 18. Për kandidaten znj. {...} - relator z. Alban Toro;
 19. Për kandidaten znj. {...} - relator z. Ilir Toska.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 9 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

**PROCESVERVBAL I PËRMBLEDHUR I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË
LARTË GJYQËSOR**

(Mbajtur, më 05.03.2020)

Pika 10 shtesë e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për një ndryshim në vendimin nr. 112, datë 09.07.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, i ndryshuar”.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:12 dhe mbaroi në orën 13:31.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Illir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
10. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)
11. ***Marçela Shehu*** (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 3. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
- 4. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
- 5. Gentiana Bigu, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 6. Alsma Shehu, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 7. Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 8. Gregor Borkowski, EURALIUS.*
- 9. Anisa Kuqi, EURALIUS.*
- 10. Valbona Bala, USAID.*
- 11. Tahir Lamçe, OSCE.*
- 12. Luljeta Laze, Drejtore e Departamentit të Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.*

RENDI I DITËS:

10 (shtesë). Shqyrtimi i projektvendimit “Për një ndryshim në vendimin nr. 112, datë 09.07.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, i ndryshuar”.

Relatore e kësaj çështjeje është zonja Brunilda Kadi.

Merr fjalën zonja Kadi e cila relaton relacionin shpjegues lidhur me përmbajtjen e projektvendimit “Për një ndryshim në vendimin nr. 112, datë 09.07.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, i ndryshuar”.

Zonja Kadi shprehet se arsyeja e këtij projektvendimi ka të bëjë me një ndryshim në listën e magistratëve udhëheqës për kandidatët magistratë gjyqëtarë për vitin akademik 2019-2020 dhe konkretisht për kandidatin z. {...} dhe magistrati gjyqëtar

udhëheqës, znj. {...} e cila ka ndryshuar seksion, me urdhër të zv/kryetarit të gjykatës, nga dhoma civile në atë penale. Duke qenë se kandidati magjistrat për periudhën mars-qershor 2020 i përkiste të bënte praktikën tek dhoma civile, Komisioni i Etikës sugjeron që për kandidatin për magjistrat z. {...}, të caktohet si magjistrat udhëheqës z. {...}, pasi ky gjyqtar nuk ka as angazhim tjetër mentorimi në të njëjtën periudhë katërmujore.

Anëtarët e Këshillit për këtë çështje të rendit të ditës nuk kanë diskutime, pyetje apo sugjerime, prandaj hidhet në votim nga Kryetarja e Këshillit propozimi i Komisionit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale për një ndryshim në vendimin nr. 112, datë 09.07.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, i ndryshuar, dhe rezultatet e votimit janë si më poshtë:

Maksim Qoku është dakord.

Brunilda Kadi është dakord.

Dritan Hallunaj është dakord.

Illir Toska është dakord.

Alban Toro është dakord.

Fatmira Luli është dakord.

Marçela Shehu është dakord.

Erjon Muharremaj është dakord.

Brikena Ukperaj është dakord.

Medi Bici është dakord.

Naureda Llagami është dakord.

Në përfundim, Këshilli vendosi: Të zëvendësojë magjistratin gjyqtar udhëheqës, znj. {...}, e caktuar për kandidatin për magjistrat, profili gjyqtar, z. {...}, për periudhën mars 2020-qershor 2020, me magjistratin gjyqtar udhëheqës, z. {...}. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 10 shtesë e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

**PROCESVERVBAL I PËRMBLEDHUR I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË
LARTË GJYQËSOR**

(Mbajtur, më 05.03.2020)

Pika 11 e rendit të ditës me objekt: Caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në Gjykatën e Lartë.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:12 dhe mbaroi në orën 13:31.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|-----------------------------|--------------------------|
| 1. Naureda Llagami | (kryetare) |
| 2. Maksim Qoku | (zëvendëskryetar) |
| 3. Medi Bici | (anëtar) |
| 4. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 5. Brunilda Kadi | (anëtare) |
| 6. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 7. Ilir Toska | (anëtar) |
| 8. Alban Toro | (anëtar) |
| 9. Brikena Ukperaj | (anëtar) |
| 10. Erjon Muharremaj | (anëtar) |
| 11. Marçela Shehu | (anëtare) |

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 3. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
- 4. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
- 5. Gentiana Bigu, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 6. Alsma Shehu, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 7. Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 8. Gregor Borkowski, EURALIUS.*
- 9. Anisa Kuqi, EURALIUS.*
- 10. Valbona Bala, USAID.*
- 11. Tahir Lamçe, OSCE.*
- 12. Luljeta Laze, Drejtore e Departamentit të Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.*

RENDI I DITËS:

11. Caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në Gjykatën e Lartë.

Relator i kësaj çështjeje është zoti Ilir Toska.

Merr fjalën zoti Ilir Toska i cili lexon relacionin shpjegues lidhur me përmbajtjen e projektvendimit “Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në Gjykatën e Lartë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, Gjykata e Lartë ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore në lëndë penale.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e kësaj çështjeje gjyqësore, të jenë gjykatat e apelit me juridiksion të përgjithshëm dhe Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe numri i gjyqtarëve të jetë 3. Gjithashtu, gjyqtarët të përzgjidhen, me short, ndërmjet atyre të cilët kanë të paktën 13 vjet përvojë në ushtrimin e profesionit, si dhe kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Sa i përket përjashtimeve nga shorti, propozohet që të përjashtohen nga shorti gjyqtarët që janë caktuar për gjykimin e kësaj çështjeje në themel, konkretisht: znj.Nertina Kosova; znj.Albana Boksi; z.Dhimitër Lara.

Diskutime/Komente/Pyetje/Propozime mbi çështjen

Zonja Ukperaj merr fjalën për të bërë një sugjerim sa i përket çështjes, duke thënë se kërkesën për përjashtim mund ta shqyrtojë z.Dvorani meqë kërkesa është për çështje penale.

Kërkesës së zonjës Ukperaj i përgjigjen disa anëtarë njëherësh që bëhet fjalë për një çështje në Gjykatë të Lartë ku gjykimi bëhet me tre gjyqtarë.

Zonja Ukperaj më pas propozon që të caktohen 2 gjyqtarë dhe jo 3, meqë gjyqtari i tretë është. Sipas saj në gjykatat e shkallës së parë dhe të apelit, në qoftë se përjashtohesh nga gjykimi në themel, nuk ka përjashtim nga kërkesa për përjashtim.

Zonja Kadi është kundër propozimit të zonjës Ukperaj pasi në qoftë se ka përjashtim për themelin, nuk mund të gjykojë as përjashtimin, kështu që zonja Kadi është për caktimin e tre gjyqtarëve.

Hidhet në votim fillimisht propozimi i bërë nga znj. Brikena Ukperaj, pra që të përzgjidhen në short 2 gjyqtarë dhe jo 3 gjyqtarë. Rezultatet e votimit janë si më poshtë:

Maksim Qoku është dakord.

Brunilda Kadi është kundër.

Dritan Hallunaj është kundër.

Ilir Toska është dakord.

Alban Toro është kundër.

Fatmira Luli është kundër.

Marçela Shehu është kundër.

Erjon Muharremaj është dakord.

Brikena Ukperaj është dakord.

Medi Bici është kundër.

Naureda Llagami është kundër.

(7 anëtarë janë kundër propozimit të zonjës Ukperaj.)

Vijohet procedura e shortit sipas propozimit të bërë nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, për përzgjedhjen e tre gjyqtarëve.

Nga shorti elektronik përzgjidhen gjyqtarët Sokol Binaj (relator) dhe anëtarë Astrit Kalaja dhe Artur Kalaja të cilët caktohen për të gjykuar çështjen e veçantë në Gjykatën e Lartë.

Me këtë çështje të rendit të ditës përfundon mbledhja e datës 05.03.2020.

* * *

(Pika 11 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor